# RAPORTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT

# SHQIPËRIA 2015

## PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Republika e Shqipërisë është demokraci parlamentare. Kushtetuta ia njeh autoritetin ligjor pralamentit me një dhomë (Kuvendit), i cili zgjedh si kryeministrin ashtu edhe presidentin. Kryeministri kryeson qeverinë, ndërsa presidenti zotëron pushtet të kufizuar ekzekutiv. Në qershor vendi zhvilloi zgjedhje lokale për kryetarë bashkie dhe këshilla bashkiakë. Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE) e vlerësoi ditën e zgjedhjeve përgjithësisht pozitivisht por vuri re disa parregullsi proceduriale. Ajo vërejti se ndonëse kuadri ligjor "mund të kishte siguruar bazën për zgjedhje demokratike," partitë kryesore "keqpërdorën pushtetet dhe përgjegjësitë e tyre të gjera brenda administratës së zgjedhjeve dhe nuk patën vullnetin politik të zbatonin kuadrin ligjor në mënyrë të efektshme." Në vitin 2013, vendi zhvilloi zgjedhje parlamentare të cilat sipas raportimit të OSBE-së ishin konkurruese dhe respektuan liritë themelore, por u zhvilluan në atmosferë mosbesimi e cila ndikoi gjithë mjedisin zgjedhor. Autoritetet mbajtën nën kontroll efektshëm forcat e sigurisë.

Problemet më serioze në lidhje me të drejtat e njeriut ishin korrupsioni i përhapur në të gjitha nivelet e qeverisjes, në veçanti brenda sistemit gjyqësor dhe sistemit të shëndetësisë, dhuna në familje dhe diskriminimi i grave.

Probleme të tjera me të drejtat e njeriut përfshinë rrahje nga policia dhe keqtrajtime të formave të tjera gjatë ndalimit të personave të dyshuar dhe marrjes në pyetje; me raste kalim i afateve të paraburgimit; dhe kushtet në burgje nën standardin e pranuar. Qeveria shënoi pak përparim në trajtimin e shumë pretendimeve për rikthimin e pronës së marrë me forcë gjatë kohës së komunizmit. Vazhdoi të kishte tregues të abuzimit të gjerë me fëmijët. Martesat me detyrim dhe të hershme ishin problem në disa pjesë të vendit. Kishte shumë fëmijë të zhvendosur dhe fëmijë rruge, veçanërisht brenda komunitetit rom. Vendi vazhdoi të ishte burim dhe destinacion për burra, gra dhe fëmijë të shfrytëzuar për trafikim për arsye seksuale dhe punë të detyruar. Marxhinalizimi dhe abuzimi me komunitetet rome dhe egjiptiano-ballkanike ishin probleme serioze, siç ishte edhe diskriminimi bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Zbatimi i ligjeve të punës nga ana e qëverisë mbeti i dobët dhe rrallë mbrojti punëtorët e brendshëm dhe migrantë. Pati një numër të madh fëmijësh të përfshirë në punë të detyruar. Pati raporte diskriminimi nga ana e punëdhënësve bazuar në gjini, aftësi të kufizuara, orientim seksual dhe identitet gjinor, kombësi dhe origjinë etnike.

Pandëshkueshmëria mbeti problem. Ndjekja penale, dhe veçanërisht prova e fajësisë, e zyrtarëve që kishin kryer abuzime mbetën sporadike dhe të paqëndrueshme. Zyrtarët, politikanët, gjyqtarët dhe ata me interesa të forta biznesi shpesh arritën të shmangnin ndjekjen penale. Autoritetet ndërmorrën disa masa administrative për të përmirësuar përgjegjshmërinë e policisë dhe dënuan disa zyrtarë të niveleve të ulëta për abuzime. Qeveria nisi hetime për disa zyrtarë të nivelit të lartë, por prokuroria më pas i pushoi çështjet.

## Seksioni 1. Respektimi i integritetit të personit, përfshirë lirinë nga:

### a. Privimi i jetës në mënyrë arbitrare ose të paligjshme

Nuk pati raportime që qeveria ose agjentë të saj të kenë kryer vrasje në mënyrë arbitrare ose të paligjshme.

Qeveria vazhdoi të bashkëvepronte me Grupin e Posaçëm Investigativ të BE-së (SITF), krijuar pas një raporti të Këshillit të Evropës (KiE) mbi krime të dyshuara nga drejtuesit e ish Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës gjatë dhe pikërisht pas luftës së Kosovës. Mandati i SITF është të hetojë dhe, nëse i lejohet edhe të përgatisë procedime penale që kanë të bëjnë me krime serioze të dyshuara në raportin e KiE, përfshirë dyshime për krime kundër civilëve që mendohet të jenë mbajtur në territorin e Shqipërisë gjatë viteve 1999 – 2000.

## b. Zhdukja

Nuk pati raportime zhdukjesh për motive politike.

Nuk pati tregues të vullnetit të autoriteteve për hetimin e zhdukjes së Remzi Hozhës, i cili dyshohet të jetë rrëmbyer në vitin 1995 nga forcat e sigurisë, as se ato do të merrnin parasysh kërkesën e kahershme të Amnesty International që trupi i tij t'i kthehet familjes ose që familja të informohet për fatin e tij.

## c. Tortura dhe trajtime ose ndëshkime të tjera mizore, çnjerëzore ose denigruese

Ndonëse kushtetuta dhe ligji i ndalon sjellje të tilla, policia dhe gardianët e burgut ndonjëherë dhunuan e abuzuan me të dyshuarit dhe të paraburgosurit. Deri në shtator, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në polici mori 50 ankesa për abuzim dhe korrupsion në radhët e policisë.

Deri në shtator, Avokati i Popullit mori 150 ankesa nga të paraburgosurit që pretendonin se oficerët e policisë kishin abuzuar me ta fizikisht, i kishin ndaluar në mënyrë të paligjshme, u kishin bërë kontroll e i kishin gjobitur në mënyrë të paligjshme; u kishin dhunuar privacinë; ose nuk u kishin dhënë informacionin e nevojshëm. Hetimi i Avokatit të Popullit në lidhje me një numër pretendimesh zbuloi se më shumë se gjysma ishin të vërteta. Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) raportoi gjithashtu se policia ndonjëherë përdorte dhunë fizike.

**Kushtet në burgje dhe në qendrat e paraburgimit**

Mjediset e mbipopulluara dhe mohimi i trajtimit mjeksor ishin probleme serioze. KSHH-ja raportoi se kushtet në disa qendra paraburgimi ishin aq të papranueshme sa përbënin trajtim çnjerëzor. Kërkimet e KSHH-së kryer me të burgosurit deri në korrik treguan se pjesa më e madhe e ankesave kishin të bënin me abuzime nga policia, kushte jo të mira jetese, abuzim psikologjik nga stafi i burgut ose të burgosurit e tjerë, ndërhyrje në letërkëmbimet me anëtarë të familjes, mosreagim ndaj ankesave dhe kërkesave të të burgosurve, dhe vonesë në transferimin e të paraburgosurve nga dhomat e ndalimit të policisë në qendrat e paraburgimit.

Kushtet fizike: Popullsia e burgut ka qenë mesatarisht 24 përqind më e madhe se kapaciteti i përcaktuar i mjediseve të burgut. Mbipopullimi ishte veçanërisht serioz në paraburgim në pritje për gjykim. Kushtet në burgje dhe qendra paraburgimi për gra ishin përgjithësisht më të mira sesa ato për burra.

Gardianët dhe të dënuar të tjerë keqtrajtuan të burgosurit dhe të paraburgosurit, duke kërcënuar jetën dhe shëndetin e tyre. Avokati i Popullit dhe organizatat joqeveritare (OJQ-të) raportuan se autoritetet mbajtën të dënuarit që vuanin nga probleme të shëndetit mendor në burgje të zakonshme, ku kujdesi për shëndetin mendor ishte tërësisht i papërshtatshëm. Qeveria raportoi shtatë raste vdekjeje në burgje deri në shtator; pesë ishin për shkaqe natyrore dhe dy vetëvrasje.

Kushtet në burgje dhe në qendrat e paraburgimit dalloheshin dukshëm nga vjetërsia dhe lloji i mjedisit. Megjithatë, KSHH-ja identifikoi probleme si në ndërtesa të vjetra edhe në ato të reja, si për shembull lagështirë në qeli, mungesa materialesh për shtretër dhe furnizim të parregullt me ujë. Kushtet në mjediset e varura nga Ministria e Punëve të Brendshme, si për shembull rajone policie dhe mjedise të përkohshme ndalimi, ishin tërësisht të papërshtatshme, përjashtuar mjediset rajonale në Tiranë, Durrës, Gjirokastër dhe Korçë, të cilat qeveria i rindërtoi në vitin 2014. Në disa raste, mjediset e paraburgimit ishin pa ngrohje gjatë dimrit. Disa kishin mungesë të komoditeteve bazë të higjienës, si për shembull dushe ose lavamane,

ishin shumë të vogla, kishin akses të kufizuar në banja, dhe pak ose aspak ajrosje, dritë natyrale, krevate ose stola. Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar, qeveria nuk ka bërë investime të mjaftueshme kapitale në infrastrukturën policore, përfshirë mjediset e paraburgimit. Burgjet menaxhohen nga Ministria e Drejtësisë.

Avokati i Popullit raportoi kushte jo të mira jetese në shumë mjedise. Kushtet në disa mjedise më të vjetra dhe në disa të reja ishin johigjienike dhe shpesh kishin mungesë të komoditeteve bazë, përfshirë përdorim uji të pijshëm, higjienë, ajrosje, ndriçim dhe kujdes shëndetësor. Avokati i Popullit dhe KSHH-ja raportuan se të paraburgosurit dhe të burgosurit nuk kishin akses të mjaftueshëm në kontrolle mjeksore dhe shërbime të tjera. Mjediset johigjienike përbënin rrezik të veçantë për personat me nevoja shëndeti mendor.

Administrimi: OJQ-të dhe Avokati i Popullit vunë re se në disa institucione, veçanërisht në rajone të vogla ose rurale policie, nuk kishte mbajtje të mirë të informacionit. Avokati i Popullit raportoi se zyrtarët e burgut përgjithësisht bashkëpunuan me hetimet, por nuk zbatuan plotësisht rekomandimet e Avokatit të Popullit. OJQ-të raportuan se, megjithëse qeveria i mori më seriozisht se në të kaluarën sugjerimet e tyre, ajo vazhdoi të refuzonte të hetonte disa raste. Avokati i Popullit zbuloi se korrupsioni ishte problem serioz në qendrat e paraburgimit, veçanërisht në lidhje me aksesin në programin e dhënies së lejes së veçantë.

Monitorimi i pavarur: Qeveria lejoi grupet lokale dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, median, si edhe trupat ndërkombëtare si Komiteti për Parandalimin e Torturës i KiE-së, të monitoronin kushtet e burgjeve. Megjithatë, Avokati i Popullit raportoi se në dy raste personeli i burgut refuzoi të lejonte monitoruesit të hynin në qendrat e paraburgimit pa miratim paraprak nga policia. Në disa raste agjencitë qeveritare nuk vunë në dispozicion sasinë e informacionit që ato kërkonin për hetimet e tyre administrative.

Përmirësimet: Gjatë vitit Avokati i Popullit dhe OJQ-të raportuan se kushtet në pjesën më të madhe të burgjeve dhe qendrave të paraburgimit u përmirësuan. OJQ-të raportuan më pak ankesa nga të paraburgosurit e rinj për raste abuzimi fizik ose dhune brenda në qendrat e paraburgimit dhe burgje, megjithëse vijonin raportet se autoritetet herë pas here nuk i merrnin seriozisht këto probleme. OJQ-të raportuan se autoritetet e policisë dhe të burgjeve treguan ndjeshmëri më të madhe ndaj të drejtave të të paraburgosurve të rinj dhe atyre femra. Avokati i Popullit raportoi se autoritetet ishin më tolerante në lejimin e të rinjve në qendrat e paraburgimit të takoheshin me të afërmit e tyre. Me hapjen e burgut të ri në Fier, autoritetet transferuan atje të burgosurit nga mjedisi i burgut Jordan Misja në Tiranë, të cilin Avokati i Popullit e kishte cilësuar të papërshtatshëm në vitin 2014. Policia, në përgjigje të kritikave për mosmbajtje të mirë të të dhënave, përmirësoi menaxhimin e të dhënave nëpërmjet zbatimit të vazhdueshëm të një sistemi elektronik. Në maj u miratuan rregullore të reja për burgjet, të cilat përfshijnë rregulla më të forta në drejtim të vizitave dhe politikave të lejes, të cilat zyrtarët e burgut më parë i manipulonin për të favorizuar të burgosurit që ishin të gatshëm të jepnin rryshfete.

## d. Arrestimi dhe ndalimi në mënyrë arbitrare

Ligji dhe kushtetuta ndalojnë arrestimin dhe ndalimin në mënyrë arbitrare, dhe qeveria në përgjithësi i zbatoi këto ndalime.

**Roli i Policisë dhe i Aparatit të Sigurisë**

Ministria e Punëve të Brendshme mbikëqyr Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe Policinë e Kufirit dhe Migracionit. Policia e Shtetit është organizmi kryesor përgjegjës për sigurinë e brendshme. Garda e Republikës mbron zyrtarët e lartë të shtetit, personalitetet e huaja dhe disa pasuri shtetërore. Ministria e Mbrojtjes mbikëqyr forcat e armatosura, të cilat ndihmojnë gjithashtu në kohë nevojash humanitare. Shërbimi Informativ Shetëror mbledh informacion, kryen veprimtari zbulimi dhe kundërzbulimi të huaj, dhe varet nga kryeministri.

Autoritetet civile në përgjithësi ruajtën kontroll të efektshëm mbi policinë, Gardën e Republikës, forcat e armatosura dhe Shërbimin Informativ Shtetëror, megjithëse disa zyrtarë përdorën herë pas here burimet shtetërore për përfitime personale dhe disa pjesëtarë të forcave të sigurisë kryen abuzime.

Policia nuk e zbatoi gjithmonë në mënyrë të barabartë ligjin. Njohjet personale, lidhjet politike ose kriminale, infrastruktura e dobët, mungesa e pajisjeve ose mbikëqyrja e dobët shpesh ndikuan zbatimin e ligjeve. Pagat e ulëta, drejtimi dhe motivimi i dobët dhe mungesa e diversitetit në vendin e punës çuan në korrupsion dhe sjellje joprofesionale të vazhduar.

Pandëshkueshmëria mbeti problem serioz, megjithëse qeveria bëri përjekje më të mëdha për ta korrigjuar, në veçanti duke rritur përdorimin e provave të filmuara për të dokumentuar dhe proceduar penalisht sjelljen e gabuar të policisë. Në qershor Prokuroria e Tiranës hoqi akuzat e ish drejtorit të përgjithshëm të policisë, Hysni Burgaj, dhe zëvendësit të tij për abuzim me detyrën, akuzë e ngritur në vitin 2014. Këto akuza u ngritën pas refuzimit të policisë, nën komandën e tyre, për ekzekutimin e urdhrave të arrestit për oficerët e Gardës së Republikës akuzuar për vrasjen e protestuesve në vitin 2011. Deri në shtator rastet e ish gardistëve, Ndrea Prendi dhe Agim Llupo, akuzuar për vrasjen e katër protestuesve në vitin 2011, mbetën përpara Gjykatës së Lartë. Gjykata po shqyrtonte rekursin e dënimeve një dhe tre vjet të dhëna nga Gjykata e Apelit për të pandehurit në vitin 2013, e cila liroi të dyshuarin e tretë.

Mbeti problem korrupsioni në Polici. (shiko seksionin 4).

Qeveria ka mekanizma për të hetuar dhe ndëshkuar abuzimin dhe korrupsionin. Shërbimi i qeverisë për çështjet e brendshme dhe ankesat kreu kontrolle, iu përgjigj ankesave dhe ndërmorri hetime serioze mbi të drejtat e njeriut, kushtet e burgjeve, dhe përkrahjen e procedurave të veprimit. Kjo zyrë iu përgjigj 472 ankesave dhe dërgoi në organin e akuzës 110 raste të dyshimit të sjelljes së gabuar të policisë gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. Gjatë vitit Avokati i Popullit gjithashtu hetoi ankesa kundër zyrtarëve të policisë, kryesisht të lidhura me probleme të arrestimit dhe paraburgimit. Avokati i Popullit, nëpërmjet mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës, raportoi rritje në zbatimin e rekomandimeve të tij në lidhje me keqtrajtimin.

Qeveria ka rritur pagat e policisë dhe ka shpallur konkurs për punësimet e reja që prej vitit 2014, megjithëse Akademia e Policisë raportohet të ketë ushtruar ndikim të papërshtatshëm mbi punësimet, pushimet nga puna dhe rritjet në detyrë.
U përmirësuan punësimet e grave.

**Procedurat e arrestimit dhe trajtimi i të paraburgosurve**

Sipas ligjit, me përjashtimin e atyre që arrestohen në flagrancë, policia mund të arrestojë një të dyshuar vetëm me mandat të lëshuar nga një gjykatë dhe të bazuar në prova të mjaftueshme. Nuk ka patur raportime në lidhje me arrestime sekrete. Me ligj, policia duhet të informojë menjëherë prokurorinë për ndalimin. Prokuroria mund ta lirojë të dyshuarin ose t'i bëjë kërkesë gjykatës brenda 48 orësh për ta mbajtur atë më gjatë. Gjykata duhet të vendosë brenda 48 orësh nëse do ta vendosë të dyshuarin në paraburgim, do të kërkojë garanci, do t'i ndalojë lëvizjet, ose do t'i kërkojë të pandehurit detyrim paraqitjeje në polici. Prokuroria kërkoi dhe gjykatat urdhëruan paraburgim në shumë raste penale. Megjithatë, gjykatat rregullisht hodhën poshtë kërkesat e prokurorisë për ndalim të të pandehurve me lidhje të forta dhe pozitë të lartë.

Kushtetuta u kërkon autoriteteve të njohin personat e ndaluar menjëherë me akuzën e ngritur kundër tyre dhe me të drejtat që ata zotërojnë. Autoritetet e zbatimit të ligjit nuk e respektuan gjithmonë këtë detyrim. Mungonte sistemi efikas për menaxhimin e aspektit monetar të garancisë. Në vend të saj, gjykatat shpesh urdhëruan të dyshuarit të paraqiteshin në polici ose prokurori një herë në javë. Ndondëse ligji u jep të ndaluarve të drejtën e marrjes së menjëhershme të një avokati, me shpenzimet e shtetit nëse është e

domosdoshme, OJQ-të raportuan se ata shpesh janë marrë në pyetje pa praninë e një avokati. Autoritetet lanë shumë të dyshuar në arrest shtëpie, shpesh me kërkesën e tyre, sepse nëse do të dënoheshin më pas u llogaritej koha nën arrest si kohë dënimi. Zyrtarët nuk i monitoruan siç duhet arrestet e shtëpisë, dhe të dyshuarit mund të lëviznin lirshëm jashtë pa u kapur.

Sipas ligjit, policia duhet të transferojë të paraburgosurit nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka mjedise më të përshtatshme për ndalim afatgjatë, nëse ndalimi kalon afatin prej 10 orësh. Për shkak të komunikimit të dobët ndërmjet ministrive, kjo ndodhi rrallë, dhe ishte e zakontë për të paraburgosurit, përfshirë të rinjtë, të mbeteshin në dhomat e ndalimit të policisë për periudha të gjata.

Arrestimi në mënyrë arbitrare: Kushtetuta dhe ligji ndalojnë arrestimin dhe ndalimin në mënyrë arbitrare. Megjithëse qeveria në përgjithësi i mori parasysh këto ndalime, pati raste të herëpashershme kur policia ndaloi persona për t'i marrë në pyetje për një kohë më të gjatë pa i arrestuar formalisht.

Ndalimi në pritje të gjykimit: Ndonëse ligji kërkon përfundim të të gjitha hetimeve përpara gjykimit brenda tre muajsh, prokuroria mund ta zgjasë këtë periudhë deri në dy vjet ose më gjatë. Ligji kërkon që ndalimi në pritje të gjykimit të mos kalojë tre vjet; nuk pati raportime që autoritetet t'i kenë shkelur këto afate gjatë vitit.
Ndalimi i gjatë përpara gjykimit shpesh ndodhi për shkak të vonesës së hetimeve, gabimeve të mbrojtjes ose mosparaqitjes me qëllim të avokatëve mbrojtës. Me ligj, gjyqtari nuk mund t'i parandalojë këto veprime ngadalësuese duke akuzuar avokatin që nuk paraqitet për fyerje të trupit gjykues. Burimet e kufizuara materiale, menaxhimi i dobët i kalendarit të gjykatës, stafi i pamjaftueshëm dhe mosparaqitja e avokatëve dhe dëshmitarëve kanë penguar sistemin gjyqësor të gjykojë çështjet sipas afateve kohore. Deri në shtator, pothuajse gjysma e popullsisë së burgjeve dhe qendrave të paraburgimit ishin në pritje të gjykimit.

Ndalim i zgjatur i azilkërkuesve të refuzuar ose personave pa shtetësi: Autoritetet shpesh ndaluan persona të parregullt që hynë pa dokumenta në vend. Policia nuk pranoi të lejonte përfaqësues të Zyrës së Komisionerit të Lartë të OKB-së për Refugjatët (UNHCR) të monitoronin procesin, ndalimin dhe deportimin e disa personave. Ishte e pamundur të përcaktohej sa prej të ndaluarve ishin refugjatë që kërkonin azil (shikoni seksionin 2.d.). UNHCR-ja raportoi se refugjatët e parregullt në paraburgim nuk kanë mundur të ushtrojnë të drejtën e tyre për të apeluar ndaj urdhrave të deportimit nga policia.

Amnestia: Në 21 dhjetor parlamenti miratoi një ligj amnistie, duke falur kështu 720 shtetas të akuzuar për vepra të lehta penale.

### e. Mohimi i gjykimit të drejtë publik

Megjithëse kushtetuta garanton gjyqësor të pavarur, trysnia politike, kërcënimi, korrupsioni i përhapur dhe burimet e kufizuara ndonjëherë ndaluan gjyqësorin të vepronte i pavarur dhe në mënyrë efikase. Seancat dëgjimore në gjykata shpesh nuk ishin të hapura për publikun. Punonjësit e sigurisë së gjykatave shpesh refuzuan të lejonin vëzhguesit në seanca dëgjimore dhe rregullisht telefononin gjyqtarin kryesues për ta pyetur nëse mund të lejonin ose jo ndonjë individ që kërkontë të ndiqte seanca të caktuara dëgjimore. Disa agjenci shfaqën një model shpërfilljeje ndaj urdhrave të gjykatës. Politizimi i emërimeve në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese kërcënuan të cenonin pavarësinë dhe integritetin e këtyre institucioneve. Deri në shtator dy vende të lira në Gjykatën e Lartë mbetën pa zëvendësuar pas thuajse dy vjetësh, pavarësisht rasteve të prapambetura me të cilat përballej gjykata.

Në përgjithësi, Ministria e Drejtësisë nuk vijoi me rigorozitet masat disiplinore kundër gjyqtarëve; megjithatë, kur e bëri këtë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ngurronte t'i vinte në zbatim ato masa. Deri në shtator ministria kishte nisur procedime disiplinore kundër tetë gjykatësve. Autoritetet pushuan dy gjykatës, paralajmëruan dy të tjerë për pushim dhe pezulluan katër.

**Procedurat e gjykimit**

Ligji i prezumon të pandehurit të pafajshëm derisa t'u jepet dënimi. Ai parashikon që të pandehurit të njoftohen menjëherë dhe me hollësi për akuzat kundër tyre, me përkthim falas nëse është e nevojshme, si dhe të kenë gjykim publik të lirë e të drejtë pa vonesa të tepruara. Sistemi i gjykatave nuk siguron gjykime me juri. Të pandehurit kanë të drejtën të konsultohen me avokat dhe t'u sigurohet një i tillë me pagesën e shtetit nëse nuk e përballojnë dot. Ligji u siguron të pandehurve kohë dhe mjedise të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen dhe të drejtën për të marrë prova të mbledhura nga organi i akuzës. Të pandehurit kanë të drejtë të përballen me dëshmitarët kundër tyre dhe të paraqesin dëshmitarë e prova në mbrojtjen e tyre. Të pandehurit nuk mund të detyrohen të dëshmojnë ose të pranojnë fajësinë.
Të pandehurit kanë të drejtën të apelojnë. Qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta, megjithëse gjyqet nuk ishin gjithmonë publike dhe mundësia për të marrë avokat disa herë ishte problematike. Pavarësisht të drejtës statutore për ndihmë ligjore falas, OJQ-të raportuan se shumë pak individë përfituan nga ligji gjatë vitit.

Në një numër vendimesh kundër shtetit, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ishte kritike në lidhje me procedurat e gjykimit. Në veçanti, kjo Gjykatë vërejti se autoritetet herë pas here nuk siguruan ose nuk regjistruan provat e dëshmitarëve, përdorën prova të marra nën torturë dhe nuk u dhanë të ndaluarve mundësi për avokat.

**Të dënuarit dhe të ndaluarit politikë**

Nuk pati raportime për të dënuar ose të ndaluar politikë.

**Procedurat gjyqësore dhe kompensimet civile**

Ndonëse individët dhe organizatat mund të kërkojnë kompensime civile për dhunim të të drejtave të njeriut, gjykatat ishin pre e korrupsionit, mungesës së efikasitetit, kërcënimeve, dhe ndërhyrjeve politike. Gjykatësit organizuan shumë seanca dëgjimore në zyrat e tyre, gjë që tregoi mungesë profesionalizmi dhe ofroi mundësi për korrupsion. Këta faktorë cenuan autoritetin e gjyqësorit, kontribuan në vendime gjyqi kontradiktore dhe çuan në zbatim të paqëndrueshëm të kodit civil. Personat që përdorën të gjitha mundësitë në gjykatat vendore mund të apelonin në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), dhe deri në shtator KSHH-ja kishte ndihmuar një të burgosur ta dërgonte çështjen në GJEDNJ. Megjithatë, në shumë raste, autoritetet nuk i vunë në zbatim vendimet e GJEDNJ. Një studim i vitit 2013 nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur për Shqipërinë—Fondacioni Soros zbuloi se avokatët, prokurorët dhe gjykatësit kishin njohuri të kufizuara në lidhje me jurisprudencën e GJEDNJ.

Personat që ishin të burgosur politikë nën regjimin e mëparshëm komunist vazhduan t'i bënin kërkesë qeverisë për kompensim. Në disa raste, pati protesta nga grupe të burgosurish politikë, përfshirë edhe greva urie, kundër mosshlyerjes së pagesave të kompesimit nga qeveria, të përfituara me ligj. Ligji i jep përparësi kompensimit të grave, të moshuarve, atyre me sëmundje serioze, dhe atyre që nuk kanë marrë asnjë pagesë. Qeveria përparoi me pagesat e kompensimeve gjatë vitit, por avokati i popullit deklaroi se ligji nuk arriti të vinte një afat të duhur për përfundimin e pagesave.

**Rikthimi i pronës**

Mijëra pretendime për pronë private dhe fetare konfiskuar gjatë periudhës së komunizmit mbetën të pa zgjidhura nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Pretenduesit mund t'i apelojnë çështjet në Gjykatën Evropiane (GJEDNJ) dhe gjatë vitit qindra raste—shumë prej tyre lidhur me pronën—ishin në pritje të shqyrtimit atje. Në shtator GJEDNJ hodhi poshtë kërkesën e autoriteteve për shtyrjen e afatit të dhjetorit për vendosjen në funksion të një mekanizmi për të kompensuar ish pronarët. GJEDNJ nxori vendime për disa raste të larta të cilat i kërkonin qeverisë të paguante palës paditëse dhjetëra miliona

dollarë si kompensim të pasurisë së konfiskuar.

### f. Ndërhyrje arbitrare në privatësi, familje, shtëpi ose korrespondencë

Qeveria shkatërroi disa shtëpi të ndërtuara pa leje si pjesë e fushatës më të gjerë të shkatërrimit të ndërtimeve të paligjshme. Qytetarët dorëzuan ankesa se qeveria, nëpërmjet Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit, i shpërfilli kërkesat e qytetarëve për të rrëzuar disa ndërtesa pa leje por zgjodhi të rrëzonte të tjera pa patur asnjë ankesë.

Në tetor bashkia e Tiranës nxorri 48 familje rome nga një ngulim përgjatë liqenit artificial të Tiranës. Autoritetet bënë përpjekje ta kompensonin këtë masë duke dhënë subvencionim për qiranë, transportin drejt komuniteteve nga ato vinin, dhe strehim të përkohshëm në streha emergjence. Ekzekutimi i këtyre planeve ishte i ngadaltë dhe i paplotë, gjë që çoi në një numër familjesh të nxjerra të ktheheshin në ngulime të tjera në qytet. Avokati i Popullit deklaroi se bashkia nuk ndoqi procedurat e ligjshme të dëbimit dhe e bëri atë përgjegjëse për mospërfshirjen e grupeve të shoqërisë civile në planet e tyre.

Në gusht qeveria shkatërroi shtëpitë e 30 familjeve të vendosura përgjatë rrugës së planifikuar të unazës së re të Tiranës. Pjesa më e madhe e banesave u përkisnin familjeve rome. Të shpronësuarit pohuan se kishin marrë njoftim me gojë vetëm 24 orë përpara nxjerrjes, thyerje kjo e procedurave të përcaktuara ligjore. Qeveria premtoi të paguante qiranë e dy viteve por nuk bëri asnjë përpjekje për të ndihmuar me rivendosjen e familjeve në shtëpitë e reja. Pjesa më e madhe e familjeve u ankuan se rimbursimi i qirasë ishte i pamjaftueshëm për familjet e mëdha. Avokati i Popullit hetoi veprimet e qeverisë dhe nxori një raport që përvijonte shkeljet ligjore. Deri në nëntor qeveria nuk kishte ndërmarrë asnjë masë korrigjuese.

**Seksioni 2. Respektimi i të drejtave të njeriut, përfshirë:**

### a. Liria e fjalës dhe e shtypit

Kushtetuta garanton lirinë e fjalës dhe të shtypit, dhe qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta. Pati raportime se qeveria, biznesi dhe grupet kriminale kërkuan të ndikonin median në mënyrë të papërshtatshme.

Liritë e shtypit dhe të medias: Media e pavarur ishte aktive dhe shprehu një gamë të gjerë pikëpamjesh, megjithëse pati disa përpjekje për të ushtruar trysni të drejtpërdrejtë ose jo, politike e ekonomike në media, përfshirë kërcënime dhe dhunë nga grupe kriminale kundër gazetarëve që u përpoqën të hetonin veprimtaritë e tyre. Trysnia politike, korrupsioni dhe mungesa e fondeve e kanë kufizuar median e shkruar të pavarur, dhe gazetarët raportuan se kishin praktikuar vetë-censurim. Një numër i vogël mediash online dhanë një pikëpamje më të pavarur.

Në raportin vjetor Indeksi i Qëndrueshmërisë së Medias, Bordi Ndërkombëtar i Kërkimit dhe Shkëmbimit (IREX) tregoi se kriza ekonomike ka tharë fondet për organizatat që nxisin të paturit e një shtypi më të pavarur, dhe shtypi ishte i prekshëm nga keqpërdorimi nën tensionet politike në rritje.

Pjesa më e madhe e shtetasve i merrnin lajmet nga televizionet dhe radioja. Pavarësia e Autoritetit të Mediave Audovizive, rregullatori i tregut të medias së transmetuar, mbeti e diskutueshme. Në nëntor të vitit 2014, pas një vonese të gjatë, u zgjodh një kryetar për të drejtuar autoritetin. Megjithatë, roli i rregullatorit mbeti i kufizuar.

Ndonëse stacionet private në përgjithësi kanë vepruar të lirë nga ndikimi i drejtpërdrejtë i qeverisë, shumë pronarë përdorën përmbajtjen e transmetimeve të tyre për të ndikuar veprimet e qeverisë drejt bizneseve të tyre. Pronarët e bizneseve gjithashtu përdorën lirshëm kompani mediatike për të përfituar favore dhe për të promovuar interesat e tyre me partitë politike. Disa kompani mediatike vazhduan të raportonin histori

investigative dhe të ekspozonin raste korrupsioni që disa herë çuan në shkarkime dhe çështje penale kundër zyrtarëve publikë të korruptuar.

Dhuna dhe ngacmimi: Pati incidente dhune dhe kërcënimi kundër anëtarëve të medias gjatë vitit dhe interesat politike dhe ato të bizneseve kanë çuar gazetarët nën trysni. Disa incidente përfshinë kërcënime të dërguara me mesazh gazetarëve nga jashtë vendit ose dërguar nëpërmjet Facebook në internet.

Censura dhe kufizimet e përmbajtjes: Gazetarët shpesh praktikuan vetë-censurimin për të shmangur rrezikun e dhunës dhe ngacmimit, dhe si reagim ndaj trysnisë prej botuesve dhe redaktorëve që kërkonin të rregullonin përmbajtjen sipas interesave të tyre politike dhe ekonomike. Mungesa e sigurisë ekonomike pakësoi pavarësinë e reporterëve dhe mund të ketë ndikuar në njëanshmëri në raportime. Unioni i Gazetarëve Shqiptarë deklaroi në shtator se 90 përqind e kompanive mediatike në vend përjetoi vonesa nga dy deri në katër muaj në pagesat e pagave të reporterëve. Problemet financiare detyruan disa gazetarë të mbështeteshin më shumë në burime të jashtme financimi.

Ligjet për shpifjen: Ligji lejon palët private të dorëzojnë padi penale dhe të marrin kompensim financiar për fyerje ose botim të qëllimshëm të informacionit të pavërtetë. OJQ-të raportuan se gjobat, të cilat mund të ishin deri në 3 milion lekë, ishin të tepërta dhe së bashku me vendosjen e një dënimi në rekordet penale të të pandehurit, ato dhunuan të drejtën e lirisë së shprehjes.

Deri në shtator rasti i Ylli Pangos ishte në pritje të seancës së dytë dëgjimore përpara Gjykatës së Lartë. Pango, ish ministër i kulturës, rinisë dhe sporteve paditi stacionin televiziv Top Channel pasi ai transmetoi regjistrime me kamera të fshehta të tij duke bërë propozime të paligjshme seksuale punonjëses së mundshme. Transmetimi çoi në shkarkimin e ministrit. Një gjykatë gjobiti Top Channel-in me 51 milion lekë për transmetimin e filmimit, por Gjykata e Apelit rrëzoi vendimin. Gjykata e Lartë e ktheu rastin për rishqyrtim në gjykatën e rrethit. Gjykata e Apelit e rrethit mori vendim kundër Pangos, i cili në janar e apeloi sërish rastin në Gjykatën e Lartë.

**Liria e internetit**

Qeveria nuk kufizoi ose ndërpreu aksesin në internet e as nuk censuroi përmbajtjen online, dhe nuk pati raportime të besueshme që qeveria të ketë monitoruar komunikimet private online pa autoritetin e duhur ligjor. Sipas të dhënave të mbledhura nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit, afërsisht 60 përqind e popullsisë përdori internetin në vitin 2013. Afërsisht 35 përqind e popullsisë u regjistruan në internet me valë të gjera në telefon. Interneti fiks ishte i përqendruar kryesisht në zonat urbane.

**Liria akademike dhe avktivitetet kulturore**

Nuk pati kufizime nga qeveria të lirisë akademike dhe aktiviteteve kulturore.

### b. Liria për grumbullim paqësor dhe formimi i shoqatave

Kushtetuta dhe ligji garantojnë liritë e grumbullimit dhe shoqatave, dhe qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta.

### c. Liria e fesë

Shikoni *Raportin Ndërkombëtar për Lirinë e Fesë* nga Departamenti i Shtetit në faqen www.state.gov/religiousfreedomreport/.

### d. Liria e lëvizjes, personat e zhvendosur brenda vendit, mbrojtja e refugjatëve dhe personat pa shtetësi

Kushtetuta dhe ligji garantojnë lirinë e lëvizjes së brendshme, udhëtimeve jashtë shtetit, emigracionin dhe riatdhesimin, dhe në përgjithësi qeveria i respektoi këto të drejta. Qeveria përmirësoi bashkëpunimin e saj me UNHCR-në dhe organizata të tjera humanitare në dhënien e mbrojtjes dhe ndihmës për refugjatët, refugjatët e kthyer, azilkërkuesit, personat pa shtetësi dhe persona të tjerë të lidhur me këto kategori. Policia e lejoi UNHCR-në të monitoronte procedimin, ndalimin dhe deportimin e disa personave.

Lëvizjet brenda vendit: Në mënyrë që të përfitojnë nga shërbimet qeveritare, individët që lëvizin brenda vendit duhet të transferojnë të dhënat e tyre civile në komunitetin e ri ku do të vendosen dhe të provojnë që banesa e tyre e re është e ligjshme nëpërmjet pronësisë së banesës, një kontrate qiraje për përdorim banese ose faturave të shërbimeve. Shumë persona nuk mund të siguronin prova të tilla dhe si rrjedhojë nuk patën mundësi të përdorin shërbimet publike. Shtetas të tjerë, veçanërisht të komunitetit rom dhe egjiptiano-ballkanikë, nuk kishin regjistrime formale në komunitetet ku ishin vendosur të jetonin. Ligji nuk e ndalon regjistrimin e tyre, por ishte e vështirë të realizohej ky regjistrim. Shumë romë dhe egjiptiano-ballkanas nuk kishin mundësitë financiare për t'u regjistruar dhe shumë nuk kishin motivimin e duhur për t'u marrë me këtë proces. Në vitin 2014 qeveria hoqi disa kërkesa për regjistrim me qëllim që të zvogëlonte barrën mbi popullsinë e marxhinalizuar.

**Mbrojtja e refugjatëve**

Gjatë vitit shumë vende në BE dhe Evropën Juglindore përjetuan një valë të paparë ndonjëherë migracioni nga Lindja e Mesme, Afrika dhe Azia, e përbërë nga azilkërkues/refugjatë, migrantë ekonomikë, dhe viktima të trafikimit, mes të tjerash. Për lehtësi, ky raport do t'i quajë këto grupe popullsie 'migrantë dhe azilkërkues' nëse nuk ka informacion më të specifikuar të disponueshëm.

Mundësia për azil: Ligji siguron garantimin e azilit ose statusit refugjat dhe qeveria ka krijuar një sistem për dhënien e ndihmës ndaj refugjatëve.

Kishte raportime të besueshme nga OJQ-të dhe migrantët dhe azilkërkuesit se autoritetet nuk ndoqën detyrimet e procedurës së duhur ligjore për disa azilkërkues dhe se në raste të tjera ata që kërkonin azil nuk kishin akses në sistem. Gjatë gjysmës së parë të vitit, afërsisht 2 000 migrantë dhe azilkërkues - kryesisht sirianë- hynë në vend. Autoritetet i kthyen pjesën më të madhe të tyre në Greqi – disa menjëherë, të tjerët pasi i mbajtën për disa muaj në mjedise të papërshtatshme. UNHCR ishte kritike në lidhje me procedurat e kontrollit dhe ndalimit të përdorura nga qeveria dhe disa azilkërkues të mundshëm u ankuan për detyrim nga ana e autoriteteve të kufirit që të mos kërkonin azil.

Ligji mbi azilin u kërkon autoriteteve të garantojnë ose mohojnë azilin brenda 51 ditësh nga kërkesa e parë e aplikantit. Azilkërkuesit nuk mund të përballen me akuza penale për hyrje të paligjshme nëse ata kontaktojnë autoritetet brenda 10 ditësh nga mbërritja në vend. UNHCR-ja raportoi se nuk kishte monitorim efikas të sistemit të azilit.

Vend i sigurt origjine/Tranzit: Ligji ndalon individë nga vende të sigurta origjine të aplikojnë për azil ose status refugjati.

Mundësi përdorimi të shërbimeve bazë: Ligji siguron për migrantët, azilkërkuesit dhe refugjatët shërbime publike, përfshirë arsim, kujdes shëndetësor, strehim, zbatim ligji, procedura gjyqësore dhe ndihmë ligjore. Migrantët dhe azilkërkuesit shpesh kërkuan ndërhyrjen e UNHCR-së ose OJQ-ve lokale për të siguruar këto shërbime.

Zgjidhje të përhershme: Qeveria vazhdoi të lehtësonte integrimin lokal të refugjatëve iranianë Mujahedin-e Khalq të cilët ishin larguar më parë për në Irak.

Mbrojtja e përkohshme: Qeveria siguroi gjithashtu mbrojtje të përkohshme për individët që mund të mos

kategorizohen si refugjatë dhe deri në tetor e ofroi këtë shërbim për tre persona.

**Personat pa shtetësi**

Në vitin 2011, viti i fundit për të cilin ka statistika të disponueshme, UNHCR-ja raportoi 7 443 persona pa shtetësi në vend. Sipas UNHCR-së, pjesa më e madhe e personave pa shtetësi ishin fëmijë romë. Arsyet e mosshtetësisë përfshinin kapërcim kufiri si migrantë dhe mosregjistrim të fëmijëve në lindje nga ana e prindërve. Qeveria bëri përpjekje për të përmirësuar regjistrimin e lindjes së fëmijëve në spitale dhe udhëzoi ambasadat e saj në vendet fqinje të ndihmonin në regjistrimin e tyre jashtë vendit.

**Seksioni 3. Liria për të marrë pjesë në procesin politik**

Kushtetuta dhe ligji përcaktojnë mundësinë e individit për të zgjedhur qeverinë në zgjedhje periodike të lira dhe të drejta bazuar në të drejtën universale dhe të barabartë të votës, dhe shtetasit e ushtruan këtë mundësi.

**Zgjedhjet dhe pjesëmarrja politike**

Zgjedhjet e fundit: Zgjedhjet kombëtare parlamentare më të afërta u zhvilluan në vitin 2013. Misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve i OSBE-së raportoi se ato "ishin konkurruese me pjesëmarrje aktive të shtetasve përgjatë gjithë fushatës dhe me respekt të vërtetë për liritë themelore." OSBE-ja vërejti: "Atmosfera e mosbesimit ndërmjet dy forcave kryesore politike ndikoi mjedisin zgjedhor dhe sfidoi adiministrimin e të gjithë procesit zgjedhor."

Në qershor vendi zhvilloi zgjedhjet lokale për kryetarë bashkie dhe këshilla bashkiakë, zgjedhjet e para që kur reforma administrative pakësoi numrin e njësive të qeverisjes lokale nga 373 në 61. OSBE-ja e vlerësoi Ditën e Zgjedhjeve përgjithësisht pozitivisht, por vërejti se ndonëse kuadri ligjor "mund të kishte siguruar bazën për zgjedhje demokratike", partitë kryesore keqpërdorën pushtetin dhe përgjegjësitë e tyre të gjera brenda administrimit të zgjedhjeve dhe nuk patën vullnetin politik të zbatonin kuadrin ligjor me efektivitet. Kjo, bashkë me politizimin e institucioneve të përfshira, penguan përparimin e procesit zgjedhor. Misioni i vëzhgimit raportoi gjithashtu se mjedisi i fushatës ishte paqësor, me përjashtim të disa incidenteve të shkëputura, dhe se liritë themelore të shprehjes dhe grumbullimit u respektuan.

Pjesëmarrja e grave dhe pakicave: Ligji drejtues i zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013 kërkonte që 30 përqind e kandidatëve të ishin gra dhe që ato të përbënin 30 përqind të posteve me emërim dhe me zgjedhje. Gratë përbënin 18 përqind të anëtarëve të zgjedhur në parlament në vitin 2013. Sipas raportit të OSBE-së për zgjedhjet, shumë parti i vendosën gratë në fundin e listave të tyre zgjedhore (të gjitha vendet në parlament mbushen me lista të mbyllura partish) dhe tre partitë e mëdha nuk e përmbushën kuotën 30-përqindëshe të detyruar për gratë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjobiti Partinë Demokratike, Partinë Socialiste dhe Lëvizjen Socialiste për Integrim për këtë shkelje por gjithsesi i pranoi listat e tyre.

OJQ-të i kritikuan partitë politike për mosemërimin e më shumë grave në Parlament nga listat e kandidatëve të partive, veçanërisht në rastet kur kishte vende bosh në Parlament, pavarësisht ligjeve të përcaktuara për të inkurajuar emërimet e grave. Zgjedhjet lokale të qershorit u organizuan pas ndryshimeve të kodit zgjedhor që u kërkonin partive të alternojnë kandidatët burra dhe gra në listat e tyre. Sipas raportit përfundimtar të OSBE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve, gratë u zgjodhën në më shumë poste, pothuajse një e treta, në këshillat lokale.

Kërkesat për regjistrim civil dhe mungesa e dokumenteve të identifikimit vështirësuan mundësitë e anëtarëve të komunitetit rom të votonin në zgjedhjet lokale të qershorit. Tarifa 1 200 lekë për një kartë identiteti ishte pengesë për disa romë që donin të regjistroheshin. Disa vëzhgues deklaruan se partitë politike ofruan të paguanin këtë tarifë në shkëmbim të votës. Deri në tetor nuk pati ministra apo deputetë romë.

**Seksioni 4. Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në qeveri**

Ligji parashikon dënime penale për korrupsionin e zyrtarëve, por qeveria nuk e zbatoi ligjin me efektivitet dhe zyrtarët shpesh u përfshinë në praktika korrupsioni pa ndëshkueshmëri.

Korrupsioni: Korrupsioni ishte i përhapur në të gjitha nivelet e qeverisjes. Gjyqe në lidhje me 25 raste u përfunduan në gjashtë muajt e parë të vitit, me rezultate dënimi fajtor për 28 të pandehur dhe një të pushuar. Deri në qershor ishin në vazhdim procedimet gjyqësore që përfshinin 48 të pandehur.

Gjatë vitit gjyqtarët në dy gjykata nuk pranuan të zgjeronin kohën e hetimit dhe e mbyllën rastin në lidhje me një gjykatës të gjykatës së apelit dhe anëtar të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të cilin prokurorët e dënuan në vitin 2014 për fshehje të pasurive, deklarim të rremë, falsifikim dokumentesh, pastrim parash dhe korrupsion. Ndërsa autoritetet po hetonin akuzat, i pandehuri programoi vlerësime performance për dy gjykatës që drejtonin këtë rast. Pala akuzuese kishte kërkuar më tepër kohë për të marrë prova nga vende të huaja.

Korrupsioni ishte problem gjithashtu në institucionet e policisë dhe ato arsimore, përfshirë universitetet publike. Përveç gjykatësve dhe zyrtarëve publikë, shumë studentë u ankuan se profesorët e tyre kërkonin rryshfete për nota kaluese në lëndët e tyre.

Gjatë vitit, autoritetet morën një sërë masash për të trajtuar korrupsionin dhe përparuan disi. Prokurorët përparuan dukshëm në ndjekjen e korrupsionit publik në nivelet e ulëta por ndjekja penale e krimeve të nivelit të lartë mbeti e pakapshme për shkak të frikës së hetuesve për ndëshkim, mungesës së përgjithshme të burimeve dhe korrupsionit në vetë degën gjyqësore. Policia vendosi sisteme kamerash në mjetet e patrullës policore me rrjedhojë refuzimin e rryshfeteve nga oficerët më shpesh, për shkak të vëzhgimit të shtuar. Qeveria zgjeroi sistemin e automatizuar për menaxhimin e thirrjeve për trafikun duke përfshirë komisionet e trafikut përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për kundravajtje trafiku, duke pakësuar kështu më shumë mundësitë për praktika korruptive.

Megjithëse Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat hetoi dhe referoi për procedurë penale një numër shumë më të lartë oficerësh policie gjatë vitit në krahasim me vitin 2014, gjykatat dënuan pak prej tyre. Në mars autoritetet krijuan një portal në rrjet që lejon shtetasit të raportojnë korrupsionin nga zyrtarët publikë. Deri në shtator portali në rrjet kishte marrë 8 749 raportime, dhe koordinatori referoi 52 prej tyre për ndjekje penale.

Një numër agjencish qeveritare hetuan raste të korrupsionit, por burimet e kufizuara, rrjedhjet e hetimit, trysnia politike e vërtetë ose perceptimi i saj dhe një sistemi i rastësishëm ricaktimi penguan hetimet. Ministria e Drejtësisë raportoi se dënimet në gjykatat e rrethit ranë me 36,8 përqind gjatë vitit në krahasim me vitin 2014. Nuk pati të dhëna të disponueshme në lidhje me dënimet në gjykatat e apelit. Në raste të përzgjedhura ku përfshiheshin aktorë ndërkombëtarë, agjencitë e antikorrupsionit bashkëpunuan me shoqërinë civile.

Deklarimet financiare: Ligji u kërkon punonjësve publikë të deklarojnë pronat e tyre në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), i cili monitoroi dhe verifikoi deklarime të tilla. Inspektorati i bëri këto deklarime të disponueshme për publikun. Gjatë vitit parlamenti autorizoi një rritje të numrit të inspektorëve të ILDKPKI-së për të hetuar deklarime të pasurive dhe konflikteve të interesit nga 12 në 15. Legjislacioni forcoi kapacitetet e institucionit dhe rriti transparencën publike. Ligji autorizon ILDKPKI-në të gjobitë zyrtarët të cilët nuk i përmbahen kërkesave për deklarim ose i referon ata në prokurori. Deri në shtator, ILDKPKI-ja kishte gjobitur 420 individë, përfshirë ministra, anëtarë parlamenti, ambasadorë dhe gjykatës, për mosdeklarimin e pasurive të tyre, për vonesën e deklarimeve ose për konflikte interesi. ILDKPKI-ja raportoi se deri në shtator ajo kishte referuar 82 raste të reja për procedim. Këto raste përfshinin 2 gjykatës, dy prokurorë, shtatë anëtarë

parlamenti, si edhe ambasadorë dhe zyrtarë të qeverisë lokale me akuza që përfshinin refuzimin për deklarim, fshehjen ose falsifikimin e deklarimeve të pasurisë, pastrim parash, falsifikim dokumentesh dhe korrupsion.

Aksesi publik në informacion: Ligji parashikon akses publik në informacionin qeveritar, por qeveria nuk e zbatoi ligjin efektshëm. Procesi i bërjes publike të informacionit shpesh nuk ishte i qartë dhe zyrtarët ndonjëherë ishin ngurrues në lëshimin e informacionit. Ligji përcakton se e drejta për të marrë informacion mund të kufizohet kur informacioni kategorizohet si i klasifikuar ose kur nxjerrja e tij do të shkelte mbrojtjen e të dhënave personale.

Pjesa më e madhe e ministrive dhe agjencive të qeverisë postuan informacion publik drejtpërdrejtë në faqen e tyre në rrjet. Bizneset dhe shtetasit u ankuan se procesi nuk kishte transparencë dhe se autoritetet nuk kishin botuar rregulla që duhet të ishin informacion publik bazë. Shtetasit shpesh u përballën me probleme serioze në marrjen e informacionit të tillë. Individët në përgjithësi mund të merrnin informacionin qeveritar falas, por kishte raste në të cilat kërkoheshin taksa procedure për të mbuluar koston e shërbimit për institucionin që jepte informacionin. Mospajtueshmëria është e ndëshkueshme si shkelje administrative, jo si shkelje penale. Shtetasit mund të apelojnë mohimin e deklarimit tek autoriteti ku bënë kërkesën fillestare ose në një gjykatë civile.

**Seksioni 5. Qëndrimi qeveritar në lidhje me hetimin ndërkombëtar dhe joqeveritar të dyshimeve për shkelje të të drejtave të njeriut**

Një numër grupesh vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut vepruan në përgjithësi pa kufizim nga ana e qeverisë, duke hetuar dhe botuar gjetjet e tyre mbi rastet e të drejtave të njeriut. Zyrtarët qeveritarë përgjithësisht ishin bashkëpunues dhe reaguan ndaj këndvështrimeve të tyre.

Organizma qeveritare të të drejtave të njeriut: Zyra e Avokatit të Popullit është institucioni kryesor për promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut. Institucioni i Avokatit të Popullit ka autoritetin dhe kërkohet me ligj të monitorojë dhe raportojë mbi burgjet dhe qendrat e paraburgimit. Ai mund të hapë hetim në disa raste kur viktima nuk mundet të dalë vetë. Megjithatë Avokati i Popullit nuk kishte fuqinë të zbatonte vendimet. Ai veproi si monitorues për shkeljet e të drejtave të njeriut. Zyra e avokatit të popullit kishte mungesa në fonde dhe në personel. Avokati i popullit raportonte në parlament çdo vit. Por edhe pse parlamenti shpërndau kopje të disa prej raportove vjetore dhe të veçanta të avokatit të popullit ose i postoi ato në internet, rrallë i diskutoi këto raporte në seanca ose komisione plenare. Parlamenti u konsultua me institucionin e Avokatit të Popullit në lidhje me projektligje që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose e përfshijnë atë por përgjithësisht e bënë këtë në çastin e fundit.

Ka një komision parlamentar për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut. Parlamenti miratoi pak ligje që synonin të shqyrtonin probleme të të drejtave të njeriut dhe zgjidhje që lidheshin me çështje të grupeve lezbike, homoseksuale, biseksuale, transgjini dhe interseksuale (LGBTI) dhe me gjakmarrjen.

**Seksioni 6. Diskriminimi, abuzimet shoqërore dhe trafikimi i personave**

Ligji ndalon diskriminimin në bazë race, gjinie, moshe, aftësie të kufizuar, gjuhe, feje, identiteti gjinor dhe/ose orientimi seksual, shëndeti, dhe gjendjeje ekonomike dhe sociale të familjes. Qeveria nuk i vuri në zbatim efektshëm këto ndalime.

Rastet e diskriminimit mbi bazën e cilësdo prej këtyre kategorive mund të sillen te komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi; komisioneri ka autoritetin të vendosë sanksione dhe e bëri këtë në disa raste gjatë vitit. Ligji e lejon komisionerin të dëshmojë në gjyq si dëshmitar ekspert, edhe në apelime të rasteve që zyra e komisionerit i ka refuzuar në fillim. Deri në shtator komisioneri mori pjesë në 20 procedime gjyqësore.

**Gratë**

Përdhunimi dhe dhuna në familje: Përdhunimi, përfshirë përdhunimin nga bashkëshorti, është krim. Ndëshkimet për përdhunim dhe ngacmim varen nga mosha e viktimës. Për përdhunimin e një të rrituri dënimi me burg është nga tre deri në 10 vjet; për përdhunimin e një adoleshenti të moshës nga 14 deri në 18 vjeç, dënimi është nga pesë deri në 15 vjet; dhe për përdhunimin e një fëmije nën moshën 14 vjeç, dënimi është shtatë deri në 15 vjet. Ligji përfshin dispozita mbi sulmin seksual dhe ngacmimin seksual dhe e bën të qartë kriminalizmin e përdhunimit bashkëshortor. Qeveria nuk e zbatoi si duhet ligjin. Viktimat rrallë raportuan abuzimin bashkëshortor dhe zyrtarët nuk e ndoqën penalisht përdhunimin bashkëshortor. Koncepti i përdhunimit bashkëshortor nuk ishte i mirëpërcaktuar, e autoritetet dhe publiku shpesh nuk e konsideruan atë si krim.

Dhuna në familje kundër grave, përfshirë abuzimin bashkëshortor, mbeti problem serioz. Policia shpesh nuk kishte trajnimin ose kapacitetin për të shqyrtuar si duhet rastet e dhunës në familje.

Një strehë shtetërore për viktimat e dhunës në familje në Tiranë ndihmoi 28 gra dhe 47 fëmijë gjatë vitit 2015 por nuk mund të pranonte viktima pa urdhër gjykate. OJQ-të drejtuan tre streha për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje si edhe të trafikimit, një në Tiranë dhe dy jashtë kryeqytetit.

Ngacmimi seksual: Ligji ndalon ngacmimin seksual, megjithëse zyrtarët rrallë e zbatuan atë. OJQ-të besonin se ngacmimi seksual është seriozisht i paraportuar. Komisioneri për mbrojtje ndaj diskriminimit në përgjithësi shqyrtoi raste të ngacmimit seksual. Komisioneri mund të vendosë gjoba deri në 80 000 lekë kundër individëve ose deri në 600 000 lekë kundër ndërmarrjeve.

Të drejtat riprodhuese: Çiftet dhe individët kanë të drejtën të vendosin për numrin e fëmijëve, distancën kohore mes fëmijëve dhe kohën kur do të kenë fëmijë, të menaxhojnë shëndetin e tyre riprodhues dhe të kenë informacion për ta realizuar këtë të lirë nga diskriminimi, detyrimi ose dhuna. Megjithatë, cilësia dhe mundësia e marrjes së shërbimit shëndetësor të siguruar nga qeveria, përfshirë kujdesin obstretik dhe atë pas lindjes, nuk ishin të kënaqshme, veçanërisht në zonat e thella rurale.

Diskriminimi: Ligji garanton status të njëjtë ligjor dhe të drejta të barabarta për gratë dhe burrat, përfshirë nën ligjet e familjes, punës, pronësisë, kombësisë dhe trashëgimisë. Gratë nuk u përjashtuan nga ndonjë profesion as me ligj e as në praktikë, por ato ishin jo të mirëpërfaqësuara në nivelet më të larta të fushave të tyre. Megjithëse ligji mandaton pagesë të barabartë për punë të barabartë, qeveria dhe punëdhënësit privatë nuk e zbatuan plotësisht këtë dispozitë. Në shumë komunitete gratë përjetuan diskriminim social bazuar në normat tradicionale sociale që i përshkruajnë gratë si të varura nga burrat. Pati raportime për diskriminim në punësim (shikoni seksionin 7.d.).

Përzgjedhja mbi pëlqyeshmërinë gjinore: Sipas agjencisë statistikore të qeverisë, raporti djem me vajza në lindje në vitin 2014 ishte 109 me 100, gjë që tregon se mund të ketë përzgjedhje me bazë pëlqyeshmërie gjinore. Qeveria nuk mbështeti përpjekjet për të shqyrtuar mosekuilibrin gjinor.

**Fëmijët**

Regjistrimi i lindjes: Individi merr nënshtetësinë me lindjen brenda territorit të vendit ose duke patur njërin prej prindërve nënshtetas. Prindërit u inkurajuan të regjistronin lindjen e fëmijës në kohën e duhur, dhe ligji parashikon një shpërblim monetar për prindërit që regjistrojnë fëmijët e tyre brenda 60 ditësh nga lindja. Megjithatë, autoritetet shpesh nuk i shpërndanë shpërblimet. Nuk pati raportime për diskriminim në regjistrimin e lindjes, por kërkesat e banesës për regjistrim e bënë atë të vështirë për shumë prindër romë dhe egjiptiano-ballkanas të cilët ishin pa vendbanime të dokumentuara ligjërisht të regjistronin fëmijët e tyre dhe të mund të merrnin shërbime shtetërore që vareshin nga regjistrimi.

Sipas degës së brendshme të OJQ-së Shoqata për Mbështetjen Sociale të të Rinjve (ARSIS), fëmijët e lindur nga migrantë të brendshëm ose nga ata që janë kthyer nga jashtë shtetit, veçanërisht nga Greqia, shpesh nuk kishin certifikatë lindjeje ose dokumentacion tjetër të ligjshëm lindjeje dhe si rrjedhojë nuk mund të ndiqnin shkollën ose të përfitonin nga shërbime të tjera. Ky problem mbetej veçanërisht i ndjeshëm për familjet rome, ku çiftet shpesh martoheshin të rinj dhe nuk regjistronin lindjet e fëmijëve të tyre.

Arsimi: Ndjekja e shkollës është e detyruar deri në klasën e nëntë ose deri në moshën 16 vjeç, cilado vjen e para, por shumë fëmijë, veçanërisht në zona rurale, lanë shkollën më parë për të punuar me familjet e tyre. Prindërit duhet të blejnë mjetet shkollore, librat, uniformat dhe ngrohësit për disa klasa; këto ishin shumë të shtrenjta deri në pengesë për shumë familje, veçanërisht familje rome dhe pakica të tjera. Shumë familje cituan gjithashtu këto kosto për mosdërgimin e vajzave në shkollë. Megjithëse qeveria kishte një program rimbursimi për familjet me të ardhura të ulëta për koston e librave shkollore, shumë familje dhe OJQ raportuan se nuk ishte e mundur të merreshin rimbursimet pas blerjes së librave.

Abuzimi me fëmijët: Vështguesit besonin se abuzimi me fëmijët ishte i përhapur, megjithëse viktimat rrallë e raportuan këtë. Në vitin 2013 Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve raportoi se 58 përqind e fëmijëve ishin viktima të abuzimit fizik, 11 përqind ishin viktima ngacmimi seksual dhe thuajse 5 përqind thanë se kishin qenë viktima të abuzimit seksual. Pothuajse 70 përqind e fëmijëve raportuan abuzim psikologjik nga anëtarë të familjes, sipas qendrës. ARSIS raportoi se deri në shtator ndihmoi me 50 raste fëmijësh të cilët ishin viktima të abuzimit psikologjik dhe fizik. Deri në nëntor OJQ-ja Terre des Hommes shqyrtoi 65 raste që përfshinin fëmijë viktima të abuzimit.

Martesa e hershme dhe me detyrim: Megjithëse minimumi i ligjshëm për martesë është 18 vjeç, autoritetet nuk e zbatuan ligjin. Martesat nën moshë ndodhën kryesisht në zonat rurale dhe brenda komunitetit rom. Sipas statistikave të vitit 2009 nga Fondi i Popullsisë i OKB-së (UNFPA), 9,6 përqind e grave nga mosha 20 dhe 24 vjeç ishin martuar përpara se të mbushnin 18 vjeç. UNFPA-ja raportoi se në vitin 2011, afërsisht 31 përqind e fëmijëve femra rome në moshën 13 deri në 17 vjeç ishin të martuara. ARSIS raportoi se, në disa komunitete rome vajzat që në moshën shtatë vjeçe dhe djemtë në moshën nëntë vjeç konsideroheshin të martuar. Deri në shtator, ARSIS ndihmoi 12 vajza nën moshë të cilat u larguan sepse familjet e tyre po i detyronin të martoheshin dhe dy ishin larguar nga 'bashkëshortët' ekzistues. Disa OJQ raportuan se martesat e hershme dhe me detyrim ndodhën në komunitete rurale si pjesë e skemave të trafikimit njerëzor, kur prindërit pranuan që vajzat e tyre nën moshë të martoheshin me burra të huaj më të mëdhenj në moshë, të cilët më pas i trafikuan ato në vende të tjera.

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve: Disa fëmijë nën moshën 18 vjeç u shfrytëzuan për prostitucion. Ndëshkimet për shfrytëzimin seksual për para të një fëmije variojnë nga tetë deri në 15 vite burgim. Vendi ka një ligj që dënon përdhunimin, dhe mosha minimale për marrëdhënie seksuale me dëshirë është 14 vjeç. Dënimi i parashikuar me ligj për përdhunimin është me burg nga pesë deri në 15 vjet. Në rrethana të rënduara, dënimi mund të shkojë deri në burgim të përjetshëm. Ligji ndalon bërjen dhe shpërndarjen e pornografisë me fëmijë; dënimet janë me burg nga tre deri në 10 vjet. Zotërimi i pornografisë së fëmijëve është i paligjshëm. Ligji qartazi përfshin minorenët në dispozita që mbulojnë abuzimet seksuale, ngacmimin, shfrytëzimin për prostitucion, përfitimin nga shërbime të ofruara nga persona të trafikuar, lehtësimin e trafikut dhe dhunën në familje. Autoritetet në përgjithësi zbatuan efektshëm ligjet kundër përdhunimit dhe shfrytëzimit seksual të minorenëve, por OJQ-të raportuan se ligjet që ndalonin pornografinë me fëmijë rrallë u vunë në zbatim.

Fëmijët e zhvendosur: Vazhdoi të kishte shumë fëmijë të zhvendosur dhe fëmijë në rrugë, veçanërisht në komunitetin rom. Fëmijët e rrugës lypnin ose bënin punë të vogla; disa migruan në vendet fqinje, veçanërisht gjatë verës. Këta fëmijë ishin më të rrezikuarit ndaj trafikimit dhe disa prej tyre u bënë viktima të trafikimit. Duke qenë se ligji ndalon procedimin penal të fëmijëve nën moshën 14 vjeç për vjedhje, bandat kriminale herë pas here përdornin fëmijët e zhvendosur për të plaçkitur shtëpi. Pati pak ndjekje të rasteve të trafikimit të fëmijëve.

Një studim i nxjerrë në maj të vitit 2014, kryer nga Fondi i Fëmijëve i OKB-së dhe Save the children me mbështetjen e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, zbuloi se më shumë se 2 500 fëmijë, afërsisht 75 përqind e tyre nga komunitete rome dhe egjiptiano-ballkanike, lypnin ose punonin në mënyrë informale në rrugë. Shumica jetonin në shtëpi me dy prindër. Shumica e fëmijëve raportuan se arsyeja kryesore pse ata lypnin ose punonin ishte të fitonin para për familjet e tyre, dhe afërsisht një e treta e tyre thanë se prindërit e tyre i detyronin të punonin. Sipas raportit, një e treta e fëmijëve që punonin ose rrinin në rrugë përballeshin me rrezikun e trafikimit. Në përgjigje të studimit, qeveria zbatoi programin pilot në Tiranë për të hequr fëmijët nga rruga duke u dhënë atyre kujdes social. Qeveria nisi gjithashtu një program pilot që jepte shtysa financiare për prindërit që t'i dërgonin fëmijët e tyre në shkolla dhe t'i vaksinonin. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, e cila monitoroi programin, raportoi se autoritetet kishin hequr 242 nga 485 fëmijët e identifikuar në rrugë gjatë vitit 2015. Punësimi i më shumë se 300 fëmijëve që mblidhnin kanabis në fushat në bashkinë jugore të Lazaratit supozohet të jetë shpërbërë ose të ketë marrë fund me shkatërrimin thuajse të plotë të fushave të kanabisit të raportuar nga policia gjatë vitit.

Fëmijët në institucione përkujdesjeje: Kishte raportime se jetimët që largoheshin nga kujdesi i shtetit në moshën e ligjshme të maturisë (18 vjeç) u përballën me probleme serioze për të gjetur banesa dhe shërbime të përshtatshme.

Rrëmbimet ndërkombëtare të fëmijëve: vendi është palë e Konventës së Hagës të vitit 1980 mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve. Për informacion shikoni raportin e pajtueshmërisë të Departamentit të Shtetit në faqen travel.state.gov/content/childabduction/en/legal/compliance.html

dhe informacionin e veçantë sipas vendit në faqen travel.state.gov/content/childabduction/english/country/Albania.html.

**Antisemitizmi**

Sipas raportimeve, në vend kishte disa qindra hebrenj. Nuk pati raportime për veprime antisemitizmi.

**Trafikimi i personave**

Shikoni *Raportin mbi Trafikimin e Personave* të Departamentit të Shtetit në faqen www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/.

**Personat me aftësi të kufizuara**

Kushtetuta dhe ligjet ndalojnë diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara fizike, ndjesore, intelektuale dhe mendore në punësim, arsim, transport, shërbime shëndetësore dhe në dhënien e shërbimeve të tjera shtetërore. Megjithatë, punëdhënësit, shkollat, qendrat e kujdesit shëndetësor dhe ofruesit e shërbimeve të tjera shtetërore disa herë u përfshinë në diskriminim. Ligji detyron që ndërtesat e reja publike të jenë të arritshme nga personat me aftësi të kufizuara, por qeveria e zbatoi ligjin vetëm në mënyrë sporadike. Sipas numërimit të popullsisë të vitit 2011, 24 përqind e personave me aftësi të kufizuara nuk kishin ndjekur asnjëherë shkollën. Varfëria e përhapur, kushtet e parregulluara të punës, dhe kujdesi i dobët mjekësor paraqitën probleme të dukshme për shumë persona me aftësi të kufizuara (shikoni seksionin 7.d.).

Në shkurt qeveria krijoi Këshillin Kombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuara, i cili përfshin persona me aftësi të kufizuara dhe anëtarë të shoqërisë civile, për të dhënë këshilla mbi çështje të aftësive të kufizuara. Qeveria ka agjenci të shërbimit social për të mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, por agjencitë shpesh kishin mungesa fondesh për zbatimin e programit. Kufizimet në burime

dhe mungesa e infrastrukturës e vështirësuan pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në çështje civile. Qendrat e votimit shpesh ishin vendosur në mjedise me mungesë akomodimi për persona të tillë.

Avokati i popullit inspektoi rregullisht institucionet e shëndetit mendor. Si pranimi edhe nxjerrja e pacientevë nga institucionet e shëndetit mendor ishin probleme për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të dhënë vlerësime të sakta psikiatrike. Kishte diskriminim social dhe stigmatizim të personave me aftësi të kufizuara mendore ose të formave të tjera.

**Pakicat kombëtare/racore/etnike**

Pati raportime diskriminimi të dukshëm të anëtarëve të komuniteteve rome dhe egjiptiano-ballkanike, përfshirë në strehim, punësim, kujdes shëndetësor dhe arsim. Disa shkolla refuzuan të pranonin nxënës romë dhe egjiptiano-ballkanas, veçanërisht nëse ata dukeshin të varfër. Pak qytete siguruan vakte dhe transport falas për nxënësit romë, por OJQ-të lokale raportuan se kjo shpesh çoi në ndarje sociale duke grupuar fëmijët romë bashkë në një shkollë, dhe se nivelet e arsimit, disiplinës dhe infrastruktura në shkollë të tilla ishin nën standardet e pranuara. Shumë shkolla të përziera që pranuan nxënës romë i marxhinalizuan ata në klasë, ndonjëherë duke i vendosur fizikisht të ndarë nga nxënës të tjerë.

OJQ të të drejtave të romëve kritikuan mungesën e mbrojtjeve ligjore kundër nxjerrjes nga shtëpia dhe shkatërrimi i kampeve të romëve përfshirë në ligjin e legalizimit të pronës. Nxjerrjet nga banesa dhe prishjet vazhduan gjatë vitit dhe ndikuan familjet rome në mënyrë jo proporcionale. Ndihma financiare e premtuar nga qeveria ishte përgjithësisht e pamjaftueshme. Çmimet e larta të shtëpive dhe mungesa e përgjithshme e vullnetit për të dhënë me qera familjeve rome e vështirësuan gjetjen e shtëpive alternative për ta, dhe shumë prej tyre vendosën të kërkonin azil në Gjermani.

Ligji siguron status zyrtar pakice për grupe kombëtare dhe veçmas për grupe etnogjuhësore. Qeveria përkufizoi grekët, maqedonasit dhe malazezët si grupe kombëtare, me grekët përbërësit e grupit më të madh ndër ta. Ligji përkufizoi arumunët (vllehët) dhe romët si grupe pakicash etnogjuhësore.

Pakica etnike greke u ankua për mungesën e vullnetit nga ana e qeverisë për të njohur qytetet etnike greke jashtë "zonave të pakicave" të përcaktuara në periudhën e komunizmit për të përdorur greqisht në dokumente zyrtare dhe në shenjat publike në zonat etnike greke, ose të përfshinin më shume grekë etnikë në administratën publike. Arsimi publik nuk ishte i disponueshëm në gjuhën rome, serbo-malazeze ose vllahe.

**Aktet e dhunës, diskriminimi dhe abuzime të tjera bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor**

Ligji ndalon diskriminimin mbi baza orientimi seksual, përfshirë në punësim (shikoni seksionin 7.d.). Gjatë vitit Komisioneri i qeverisë për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori disa ankesa nga individë dhe organizata LGBTI. Zbatimi i ligjit në përgjithësi ishte i dobët.

Orientimi seksual dhe identiteti gjinor janë ndër klasat e mbrojtura nga ligjet e vendit për krimet e urrejtjes. Pavarësisht ligjit dhe mbështetjes formale të qeverisë për të drejtat LGBTI, qëndrimet homofobike vazhduan në jetën private dhe publike. Zyrtarët publikë ndonjëherë bënë deklarata homofobike. OJQ-të raportuan shtim të familjeve që nxjerrin personat nga shtëpia e tyre gjatë vitit. Që në vitin 2014 streha e parë për personat LGBTI të përzënë akomodoi tetë individë. U hapën OJQ-të Aleanca dhe ProLGBT në vitin 2014.

Në 17 maj aktivistët morrën pjesë në Pedalimin e katërt Gej në Tiranë kundër Homofobisë, një pedalim i shkurtër me biçikleta në bulevardin kryesor të Tiranës, si edhe në panairin e diversitetit. Të dyja u kryen pa incidente, ndryshe nga vitet e mëparshme. Në 11 qershor një aktivitet i dytë krenarie u organizua në

Tiranë si pjesë e "festivalit të diversitetit." Policia garantoi sigurinë e aktivistëve gjatë aktiviteteve.

**Stigma sociale lidhur me HIV SIDA**

Ligji ndalon diskriminimin e personave me HIV/SIDA. Megjithatë, në anketën më të fundit demografike dhe të shëndetit (2008-09), 71 përqind e grave dhe 69,3 përqind e burrave HIV-pozitivë raportuan sjellje diskriminuese drejt personave me HIV. Persona të tillë përjetuan stigmë të përgjithshme sociale, megjithëse nuk pati raportime dhune kundër individësh të tillë gjatë vitit.

**Forma të tjera dhune dhe diskriminimi social**

Incidente vrasjesh shoqërore, përfshirë "gjakmarrjen" dhe vrasjet për hakmarrje, ndodhën gjatë vitit. Media pasqyroi disa vrasje në lidhje me banda si vrasje për gjakmarrje, dhe kriminelët disa herë përdorën termin për të justifikuar krimet e tyre. Nuk pati raste minorenësh ose grash viktima të gjakmarrjes. Avokati i Popullit raportoi se përpjekjet e autoriteteve për të mbrojtur familjet ose për të parandaluar vrasjet për gjakmarrje nuk ishin të mjaftueshme, megjithëse qeveria shtoi përpjekjet për të hetuar krime të tilla.

**Seksioni 7. Të drejtat e punëtorëve**

### a. Liria e grupimit në shoqata dhe e drejta për marrëveshje kolektive

Ligji dhe rregullore e statute të tjera të lidhura me të sigurojnë të drejtët për pjesën më të madhe të punonjësve të formojnë sindikata, të bëjnë greva të ligjshme dhe të bëjnë marrëveshje kolektive. Qeveria i zbatoi këto ligje efektivisht. Ligji ndalon diskriminimin kundërsindikatë dhe siguron rikthimin në punë të punonjësve të pushuar për shkak të veprimtarisë në sindikatë. Ligji nuk lejon anëtarë të ushtrisë dhe zyrtarë të lartë të qeverisë të bëhen pjesë e sindikatave dhe kërkon që një sindikatë të ketë së paku 20 anëtarë për t'u regjistruar. Ligji garanton të drejtën e grevës për të gjithë punëtorët me përjashtim personelin ushtarak në uniformë, personelin e policisë, personelin e domosdoshëm mjekësor e spitalor, personat që ofrojnë shërbim të kontrollit të trafikut ajror dhe shërbime në burgje, si edhe punonjësit e domosdoshëm ose jo të ujësjellësit dhe kompanisë së energjisë elektrike. Punonjësit që nuk përjashtohen nga pozicionet e tyre e ushtruan të drejtën e tyre për grevë. Këto ligje rrallë mbrojtën punëtorët shtëpiakë dhe migrantët. Transparency International raportoi se sindikatat e punonjësve ishin të dobëta, dhe se autoritetet dhe kompanitë private ishin në mënyrë të rregullt në kundërshti të përpjekjeve të organizimit dhe marrëveshjeve kolektive.

Zbatimi i këtyre ligjeve nga qeveria mbeti gjerësisht jo efektik. Burimet për kryerjen e inspektimeve dhe kompensimin e shkeljeve nuk ishin të mjaftueshme. Dënimet, përfshirë gjobat deri në pesëdhjetëfish të pagës minimale nuk ishin të mjaftueshme për të frenuar shkeljet. Masat administrative dhe proceduriale iu nënshtruan vonesave të gjata dhe apelimeve. Procedurat e arbitrazhit lejuan vonesa të mëdha të cilat kufizuan mbrojtjen e punonjësve kundrejt veprimtarisë kundër sindikatës.

Punonjësit civilë në të gjitha fushat kanë të drejtën kushtetuese të organizohen dhe të bëjnë marrëveshje kolektive, dhe ligji përcakton procedura për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve nëpërmjet marrëveshjeve për diskutim kolektiv. Sindikatat që përfaqësonin punonjësit e sektorit publik negociuan në mënyrë të drejtpërdrejtë me qeverinë. Marrëveshjet e efektshme kolektive mbetën të vështira me punëdhënësit që ishin kundër organizimit të sindikatave dhe veprimtarive të tyre. Në këtë mjedis, marrëveshjet kolektive edhe kur arriheshin ishin të vështira për t'u zbatuar.

### b. Ndalimi i punës me detyrim

Ligji ndalon të gjitha format e punës së detyruar por qeveria nuk e zbatoi gjithmonë me efektshmëri këtë

ligj. Mungesa e koordinimit mes ministrave dhe natyra sporadike e zbatimit të procedurava standarde të veprimit vështirësuan zbatimin. Dënimet prej tetë deri në 15 vjet në burg ishin mjaftueshëm të ashpra për të frenuar shkeljet. Organizatat e zbatimit të ligjit trajnuan punonjësit e tyre me një qasje me në qendër viktimat e trafikimit njerëzor. Qeveria vazhdoi të identifikonte viktima trafikimi por ndoqi penalisht dhe dënoi një numër të vogël trafikuesish. Zyra e Koordinatorit Kombëtar kundër Trafikimit ishte e efektshme në ruajtjen e përpjekjeve të qeverisë kundër trafikimit.

Pati raste të punës së detyruar gjatë vitit. Fëmijët iu nënshtruan lypjes me detyrim dhe aktiviteteve kriminale (shikoni seksionin 7.c.).

Shikoni gjithashtu *Raportin mbi Trafikimin e Personave* të Departamentit të Shtetit në faqen www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/.

### c. Ndalimi i punës së të miturve dhe mosha minimale për punësim

Ligji përcakton moshën minimale për punësim në 16 vjeç dhe rregullon sasinë dhe llojin e punës që fëmijët nën moshën 18 mund të kryejnë. Fëmijët nga mosha 16 deri në 18 vjeç mund të punojnë në disa punë të përcaktuara. Sipas ligjit, Inspektorati Shtetëror i Punës, nën Ministrinë e Rinisë dhe Mirëqënies Sociale, është përgjegjës për fuqizimin e kërkesave të moshës minimale nëpërmjet gjykatave, por Inspektorati Shtetëror i Punës nuk e zbatoi si duhet ligjin. Inspektorët e punës hetuan sektorin e punës formale, ndërkohë që pjesa më e madhe e punës së të miturve kryhej në sektorin informal.

Pjesa më e madhe e inspektimeve të punës u krye në fabrikat e këpucëve dhe të tekstileve, në call centers dhe në sipërmarrjet me pakicë; zyrtarët gjetën disa raste që përfshinin punë të miturish gjatë inspektimeve të tyre. Dënimet për shkeljet e ligjit përfshijnë gjoba deri ne 50-fishin e pagës minimale; këto nuk ishin të mjaftueshme për të frenuar shkeljet.

Në vitin 2013 agjencia shtetërore e statistikave dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës llogariti 54 000 fëmijë të përfshirë në punë të detyruar në vend. Rreth 43 000 fëmijë punonin në ferma dhe peshkim, 4 400 në sektorin e shërbimeve dhe 2 200 në hotele dhe restorante. Afërsisht 7 përqind e fëmijëve ishin punonjës të mitur.

Inspektorati Shtetëror i Punës monitoron rastet e punës së fëmijëve dhe praktika të tjera të gabuara të punës, por burimet e pamjaftueshme njerëzore kufizuan veprimtarinë e tij. Në vitin 2015 inspektorati raportoi se kishte 110 inspektorë, numër në rritje nga 98 në vitin 2014.

Ligji kriminalizon shfrytëzimin e fëmijëve për punë dhe shërbime të detyrurara, por qeveria nuk e zbatoi si duhet ligjin. Raportet vërejtën se një pjesë e madhe e punonjësve të mitur punuan si shitës në rrugë ose në dyqane, lypës, fermerë, barinj, kontrabandistë droge, larës makinash, punonjës në fabrika tekstilesh, minierë, ose llustrues këpucësh. Disa prej fëmijëve që lypin në rrugë ishin brez i dytë ose i tretë lypësish.

Kërkimet treguan se lypja niste që në moshën katër ose pesë vjeçare. Ndonëse kodi penal ndalon shfrytëzimin e fëmijëve për lypje, policia në përgjithësi nuk e zbatoi ligjin, megjithëse bëri përpjekje më të mëdha për ta bërë këtë gjatë vitit (shikoni seksionin 6, Fëmijët e zhvendosur).

Shikoni gjithashtu *Të Dhënat mbi Format më të Këqija të Punës së të Miturve* të Departamentit të Shtetit në faqen www.dol.gov/ilab/reports/child-labor/findings/.

### d. Diskriminimi në lidhje me punësimin ose zanatin

Ligjet e punës e ndalojnë diskriminimin në punë për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar fizike dhe mendore, besimeve politike, kombësisë, besimit fetar, familjes dhe origjinës sociale. Diskriminimi në punësim dhe zanat ndodhi në lidhje me gjininë, paraqitjen e një aftësie

të kufizuar, orientimit seksual dhe identitetit gjinor, kombësisë dhe etnisë.

### e. Kushtet e pranueshme të punës

Paga minimale kombëtare ishte 22 000 lekë në muaj. Krahasimisht pragu i varfërisë në nivel kombëtar në vitin 2013 ishte 6 665 lekë në muaj. Ligji kërkon pagesë të barabartë për punë të barabartë. Inspektorati Shtetëror i Punës është përgjegjës për zbatimin e pagës minimale.

Ndonëse ligji përcakton javën 40-orëshe të punës, java aktuale e punës u përcaktua me marrëveshje individuale ose kolektive. Ligji përcakton pushime vjetore të paguara, por vetëm punonjësit në tregun formal të punës kishin të drejta për pushime të paguara. Shumë persona në sektorin privat punuan gjashtë ditë në javë. Ligji kërkon pagesa për orarin shtesë dhe punë gjatë ditëve të pushimit, por punëdhënësit nuk i zbatuan gjithmonë këto përcaktime. Ligji kufizon maksimumin e orëve të punës në 40 në javë dhe përcakton pagesë shpërblyese për punën jashtë orarit. Qeveria nuk kishte standard për numrin minimal të pushimeve në javë dhe rrallë zbatoi ligje që lidheshin me maksimumin e orëve të punës, kufij në punë jashtë orarit, ose pagesë shpërblyese për punë jashtë orarit, veçanërisht në sektorin privat. Këto ligje nuk zbatoheshin për punonjësit në sektorin informal, si për shembull punonjësit shtëpiakë dhe punonjësit migrantë.

Inspektorati Shtetëror i Punës është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe rregulloreve për shëndetin dhe sigurinë profesionale. Mungonte në përgjithësi zbatimi. Kushtet e vendit të punës në prodhim, ndërtim dhe sektorin e minierave shpesh ishin të dobëta dhe në shumë raste të rrezikshme. Burimet dhe inspektimet nuk ishin të mjaftueshme dhe dënimet me gjobë deri në 50-fishin e pagës minimale (10 000 dollarë) shpesh nuk frenuan shkeljet pasi agjencitë e zbatimit të ligjit nuk kishin mjetet për zbatimin e mbledhjes dhe si rrjedhojë rrallë gjobitën shkelësit. Nuk kishte programe qeveritare që të siguronin mbrojtje sociale për punonjësit në ekonominë informale.

Shkeljet e standardeve të sigurisë profesionale ndodhën më shpesh në industritë tekstile, të këpucëve/sandaleve, ndërtimit dhe minierave. Punëtorët shpesh nuk mund të dilnin nga situata që rrezikonin shëndetin ose sigurinë e tyre pa rrezikuar punësimin e tyre. Punëdhënësit nuk i mbrojtën efektivisht punonjësit në këto situata.